

Porti dhe Sporti, promotor i kampionatit të futbollit të nxënësve ó Kalendar

04.11.2011

Autoriteti Portual është bërë promotori i veprimtarisë sportive njëmuore, që do të nisë më 4 nëntor 2011 në kompleksin “Niko Dovana”.

Nxënësit e 16 shkollave të mesme të qytetit në kuadër të projektit “Porti dhe sporti” do të jenë protagonistë të Kampionatit të Futbollit (kalçeto), i cili do të zhvillohet çdo të premtë paradite nga 4 nëntor deri më 2 dhjetor në takimin final.

Kampionati do të zhvillohet i ndarë me dy grupe me nga 8 skuadra, përkatësisht A-shkollat publike dhe B-shkollat private. Kalendar i ndeshjeve është hedhur me short.

Takimi final do të organizohet në Pallatin e Sportit “Ramazan Njala” më 2 dhjetor dhe shkolla fituese krahas medaljeve dhe Kupës do të shpërblehet me sponsorizimin e një eskursionit për klasat e nxënësve pjesëmarrës në ekipin përfaqësues.

Drejtoria Arsimore Rajonale, e cila mundëson selektimin dhe organizimin e nxënësve në ditët e ndeshjeve dhe klubi I futbollit “Teuta”, që ka vënë në dispozicion fushat e futbollit, mjediset e zhveshjes së nxënësve-sportistë dhe personat përkatës profesionistë janë dy partnerët e kësaj veprimtarie.

Autoriteti Portual ka financuar me 1 milion lek të rinj organizimin e këtij kampionati, i cili nuk zhvillohej prej shumë kohësh në qytetin tonë. Disa muaj më parë APD mbështeti klubin e futbollit “Teuta” për ngritjen e kullave të ndriçimit të fushave të stërvitjes në kompleksin sportiv.



Grafiku i ndeshjeve

(4 nëntor)

Ora 11:00

Aneksi i stadiumit, fusha 1

Shkolla "Konica"-Shkolla "Migjeni" (fituesi a)

Ora 11:00

Aneksi i stadiumit, fusha 2

Shkolla "Naim Frashëri"-Shkolla Teknologjike (fituesi c)

Ora 12:30

Aneksi i stadiumit, fusha 1

Shkolla Turgut Ozal-Shkolla Mjeshtëria Sportive (fituesi b)

Ora 12:30

Aneksi i stadiumit, fusha 2

Shkolla "Olsi Lasko"-Shkolla "Talenti" (fituesi d)

11 nëntor

Ora 11:00

Aneksi i stadiumit, fusha 1

Shkolla "Gjergj Kastrioti"- Shkolla "Mihal Ikonomi" (fituesi e)

Ora 11:00

Aneksi i stadiumit, fusha 2

Shkolla "Rilindja"- Shkolla "Durrahu", (fituesi g)

Ora 12:30

Aneksi i stadiumit, fusha 1

Shkolla "Leonik Tomeo"- Shkolla "Beqir Çela" (fituesi f)

Ora 12:30

Aneksi i stadiumit, fusha 2

Shkolla e mesme Shijak- Shkolla "Kasa" (fituesi h)

18 nëntor

Ora 11:00

Aneksi i stadiumit, fusha 1

Fituesi a – fituesi h (fituesi α)

Ora 11:00

Aneksi i stadiumit, fusha 2

Fituesi b – fituesi g (fituesi β)

Ora 12:30

Aneksi i stadiumit, fusha 1

Fituesi c- fituesi f (fituesi μ)

Ora 12:30
Aneksi i stadiumit, fusha 2
Fituesi d – fituesi e (fituesi π)

25 nëntor

Ora 11:00
Pallati i Sportit
fituesi α - fituesi μ (fituesi 1)

2 dhjetor

Ora 11:00
Pallati i Sportit
Fituesi β - fituesi π (fituesi 2)

Finalja 9 dhjetor

Ora 11:00
Pallati i Sportit “Ramazan Njala”
Fituesi 1- fituesi 2